



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS NOVOBËRD

Numri i lëndës: 2022:069891

Datë: 16.06.2022

Numri i dokumentit: 03138372

CN.nr. 06/2022

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Gazmend Ajvazi, në çështjen juridike të propozuesit P... F...C... P... SH.P.K si person juridik tek Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK) me seli dhe adresë Dobrajë e Madhe, Rr” Avdi Mehmeti”, përfaqshuar nga A.. B..., A.. A. M..., të cilën e përfaqshon sipas autorizimit Zyra Ligjore, Pro Juris Av.Arbër Krasniqi nga Prishtina Rr” Hajdar Dushi’ C-D,H-I, nr.1 kati I në Prishtinë, me propozim për sigurimin e para provës, pas shqyrtimit paraprak të propozimit jastë seancës më datën 16.06.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

I.HUDHET poshtë si i pa lejuar propozimi i propozuesit, P.. F..C... P.. SH.P.K, si person juridik tek Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK) me seli dhe adresë Dobrajë e Madhe, Rr” Avdi Mehmeti”, përfaqshuar nga A..B...., A.. A. M...., në çështjen jo kontestimore për nxjerrjen e proves, daljen e gjykatës në vendin e ngjarjes për identifikimin e uzurpatorëve dhe vërtetimin e gjendjes faktike.

A r s y e t i m

Propozusi P... F.. C... P...s SH.P.K, si person juridik tek Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (arbK) me seli dhe adresë Dobrajë e Madhe, Rr” Avdi Mehmeti”, përfaqshuar nga i A... B..., A... A. M... më dt.07.04.2022, përmes përfaqësuesit të tij, në gjykatë ka ushtruar propozim për sigurimin e provës-para provës me propozim që gjykata të del në vendin e ngjarjes për të konstatuar gjendjen faktike dhe për të identifikuar uzurpatorin . Më tej ka shtuar se propozuesi në cilësi të blerësit ka blerë disa parcela sipas qertifikatës pronësore me nr. të lëndës 1835/20 i dt.07.12.2020 nga shitësja M. B.I. dhe kanë lidhur kontratë mbi shitblerjen e paluajtshmërisë me shenjën LRPnr.1879/20 Ref.Nr.1162/20 me qmimin kontraktual prej 200,000.00€. Pronari i ri tani propozuesi është investitor i huaj dhe ka interes që të merr në posedim faktik pronën e blerë, sipas kontratës së lartcekur mirpo ka hasur në pengesa pasi që dikush – i panjohur e ka bërë ndërrmin e bravavae të dymve, duke i’a pamundësuar shfrytëzimin faktik të pronë blerësit dhe i ka pa mundësuar hyrje në shtëpinë e investitorit të huaj. Me këto veprime kemi të bëjmë me uzurpim të pronës nga personat të pidentifikuar nga ana jonë.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të propozimit konstatoi se uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme është vepër penale sipas nenit 332 të KPRK-së, andaj kjo çështje nuk hynë në kompetencën gjyqësore-lëndore në Divizionin Civil të gjykatës.

Në bazë të të cekurave më lart bazuar në nenin 17 të LPJK-së dhe nenit 391 pika a) e LPK-së, gjykata vendosi, si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
CN.nr.06/2022 me datë 16.06.2022

Gjyqtari,
Gazmend Ajvazi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 15 ditë, pas ditës së pranimet të të njëjtit. Ankesa dorëzohet në kopje të mjaftueshme përmes kësaj gjykate.